


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE E JURIDIKSIONIT TE
PERGJITHSHEM TIRANE

NR. 8762 AKTI

Dr rregjistrimi 02.08.2023

Dt 04.03.2024

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, e perbere nga:

ANTONELA PRENDI – GJYQTARE

asistuar nga sekretare gjyqesore Aurora Cahani sot me dt 04.03.2024
mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike ceshtjen civile me nr 8762
Akti, qe i perket :

KERKUES :

Shoqeria “ Besa Agro Invest “ sh.p.k, rregjistruar me
dt 26.05.2014, me qender ne Fushe Kruje Arrameras,
nr pasurie 328/75, vol 14, fq 209, ZK 1042, NIPT
L41726002A, perfaqesuar nga administratori Estref
Cekrezi dhe avokati Taulant Naco.

OBJEKTI :

Kerkese per fillimin e procedures se falimentimit te
shoqerise tregetare “ Besa Agro Invest “ sh.p.k me
kerkese te debitorit. Caktimin e administratorit te
falimentimit. Vendosjen e mases se sigurimit mbi te
gjitha pasurite e luajtshme, te paluajtshme si dhe te
drejtat e debitorit.

BAZA LIGJORE :

Nenet 7, 13, 14,15, 17 te ligjit nr 110/2016, dt

27.10.2016 „, Per falimentimin “. Nenet 41, 42, 153, 334
te KPrC.

Gjykata pasi administroi provat, deklaroi te mbyllur hetimin gjyqesor, degjoi konkluzionet perfundimtare te pales kerkuese e cila kerkoj pranimin e kerkeses dhe si cmoi provat ne teresi

V E R E N

Prane kesaj gjykate eshte paraqitur per gjykim kerkesa per celjen e procedures se falimentimit te shoqerise tregtare “ Besa Agro Invest “ sh.p.k ne baze te ligjit nr 110, dt 27.10.2016 „, Per falimentimin “.

Kjo ceshtje eshte paraqitur fillimisht per gjykim prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Durres, e cila me vendimin nr 1027, dt 31.07.2023 vendosi :

1. *Shpalljen e moskompetences tokesore te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Durres per shqyrtimin e ceshtjes civile nr 2789 Akti, dt rregjistrimi 25.07.2023 me kerkues shoqeria “ Besa Agro Invest “ sh.p.k, me seli ne Fushe Kruje.*

2. *Dergimin e kerkeses dhe akteve bashkelidhur saj gjykates kompetente, Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane... “*

Pas zhvillimit te nje hetimi te plote dhe te gjithanshem te ceshtjes, administrimit te provave dhe cmimit ne teresi te tyre rezultoi e provuar :

“ Besa Agro Invest “ sh.p.k eshte subjekt i te drejtes tregtare, e rregjistruar ne QKB ne dt 26.05.2014, me qender ne Fushe Kruje Arrameras, nr pasurie 328/75, vol 14, fq 209, ZK 1042, NIPT L41726002A dhe objekt veprimtarie : „ *Kultivim i kulturave te ndryshme bujqesore dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice. Kultivimi i ullirit, vreshtave, pemeve frutore me qellim tregtimin e produkteve dhe nenprodukteve te tyre me shumice dhe pakice. Prodhimi i farerave, fidaneve dhe tregtimi i tyre. Ngritja e industrise perpunuese te prodhimeve bujqesore dhe blegetorale. Ngritja dhe zhvillimi i agroturizimit. Eksperimentimi i teknologjive te reja ne kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore. Import, eksport, tregtim me shumice dhe pakice i te gjitha produkteve bujqesore dhe blegetorale. te perpunuara, te fresketa, te gjalla, blerjes se farerave, fidaneve, medikamenteve te ndryshme per mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit. Import, eksport dhe tregtim me shumice dhe*

pakice i makinerive per prodhim bujqesor dhe blegetoral, traktore, mjete transporti, linja dhe makineri te perpunimit te produkteve agro ushqimore. Nxitjen dhe organizimin e te gjitha aktiviteteve qe kane te bejne me prodhimin dhe perpunimin e produkteve te fermereve. Konsulence ne fushen e ekonomise, bujqesise, blegetorise dhe ushqimit duke perfshire planet e menaxhimit te cilesise, mjedisit, turizimit dhe agroturizmit. Shoqeria do te ushtroj aktivitetin e saj bazuar te lejet, licensat aprovimet apo autorizimet e tjera te ligjshme te leshuara nga institucionet qeveritare kompetente te fushes”.

Kapitali i shoqerise eshte 485.000.000,00 lekë. Ortaku i vetem i shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k i cili zoteron 100 % te kuotave eshte fondacioni “ Albanian Besa Capital”, i rregjistruar me vendimin nr 287, dt 19.09.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (*te dhenat ne lidhje me kete fondacion persa i perket objektit te veprimtarise, organizimit dhe perberjes se organeve drejtuese pasqyrohen ne vertetimin dt 20.07.2023 leshuar nga Zyra e Rregjistrimit te OJF-ve prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane*). Ndersa administrator i shoqerise eshte z.Estref Cekrezi.

Shoqeria “ Besa Agro Invest “ sh.p.k, ne pozicionin e subjektit debitor i eshte drejtuar gjykates me ane te kesaj kerkese per hapjen e procedurave te falimentimit ne baze te ligjit nr 110/2016 “ Per falimentimin” . Pala kerkuese pretendon ekzistencen e shkaqeve ligjore per celjen e falimentimit te shoqerise, mbeshtetur ne dokumentacionin provues qe bashkeshoqeron kerkesen, ne perputhje me nenin 14 te ligjit “ Per falimentimin “. Ne argumentimin e saj ligjor pala kerkuese parashtroi :

-shoqeria “ Besa Agro Invest “ sh.p.k eshte person juridik qe ushtron aktivitet tregetar ne fushen e kultivimit te kulturave bujqesore dhe tregetimin e tyre me shumice e pakice. Vitet e fundit shoqeria eshte perballur me veshtiresi financiare, te shkaktuara nga perkeqesimi i situates se likuiditeteve si pasoje e rrenies se shitjeve. Referuar raportit te paaftesise paguese te paraqitur ne gjykim rezulton se shuma e detyrimeve qe shoqeria ka ndaj te treteve eshte 288 967 508 leke, e perbere nga detyrimi ndaj Bashkise Kruje 5 016 878 leke, detyrimi ndaj Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural 281 055 127.48 leke dhe detyrimi ndaj furnitoreve 2 895 503 leke. Shoqeria ka detyrime te maturuara dhe paaftesi paguese, fakt qe dikton nevojën e likuidimit te pasurive dhe shperndarjes se te ardhurave nepermjet procedures se falimentimit. Kjo procedure synon te shlyej ne menyre kolektive detyrimet e debitorit permes shperndarjes se te ardhurave qe mund te sigurohen nga shitja e pasurive te tij ose arritjes se nje marreveshje per riorganizimin e aktivitetit.

-debitori “ Besa Agro Invest “ sh.p.k legjitimohet ne paraqitjen e kerkeses per celjen e procedures se falimentimit. Ne baze te nenit 14 te ligjit ‘Per falimentimin “ kerkesa e debitorit per hapjen e procedures se falimentimit bazohet ne paaftesine e tij paguese ekzistuese ose ate qe mund te krijohet ne nje te ardhme te afert. Inicimi i procedurave te falimentimit bazohet ne vendimmarrjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve nr 105, dt 17.07.2023, e cila ka autorizuar njekohesisht administratorin e shoqerise te nenshkruaj kerkesen drejtuar gjykates dhe te ndjeke procedurat gjyqesore.

-shoqeria paraqiti te gjithe dokumentacionin e percaktuar ne nenin 14 te ligjit „ Per falimentimin“ ne te cilin pasqyrohet teresia e te dhenave financiare ne lidhje me aktivitetin e saj ekonomik ne funksion te provueshmerise se shkakut te celjes se procedures se falimentimit (pasqyrat financiare te shoqerise, ekstrakti i QKB, lista e kreditoreve dhe debitore, lista e pasurive, e mjeteve monetare etj).

-ekzistenca e shkakut te falimentimit u vertetua dhe nga ekspertimi kontabel i realizuar gjate gjykimit. Ekspertja konkludoi se shoqeria nuk disponon likuiditete te mjaftueshme per shlyerjen e detyrimeve te papaguara ndaj kreditoreve, shoqeria ndodhet ne kushtet e paaftesise paguese,por ka mundesi financiare per te mbuluar kostot e procedures se falimentimit. Gjykata duhet te urdheroj hapjen e procedures se falimentimit te shoqerise e cila eshte jo vetem nje suate ligjore qe pasqyron efektivisht pamundesine e debitorit per vazhdimesine e metejshme te aktivitetit, por rregullon dhe te drejtat e kreditoreve karshi subjektit debitor sipas radhes se preferimit te percaktuar ne ligjin „ Per falimentimin“. Gjykata nuk duhet te mjaftohet me nje analize te thjeshte te pasqyrave financiare, por detyrohet te analizoj ne menyre te hollesishme gjendjen e debitorit, me qellim mbrojtjen e dyfishte si te ketij subjekti qe i nenshtrohet procedures, ashtu dhe kreditoreve dhe te drejtave te tyre ndaj pasurive te debitorit.

Gjykata pasi analizoi ne teresi provat ne kendveshtrim te dispozitave ligjit nr 110/2016 “ Per falimentimin” konkludon se kerkesa e shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k eshte e bazuar dhe per kete shkak vendos pranimin e saj.

Paraprakisht gjykata cmon te nenvizoj disa aspekte procedurale te lidhura me gjykimin e kesaj kerkeses si me poshte vijon :

-kerkesa eshte rregjistruar per gjykim me dt 25.07.2023.Kuadri ligjor i zbatueshem per shqyrtimin e kerkeses per celjen e procedures se falimentimit eshte ligji nr 110/2016 “ Per falimentimin”, i cili ka qene ne fuqi ne kohen e

paraqitjes per shqyrtim te kesaj kerkese. Per ceshtje qe nuk gjejne rregullim ne kete ligj gjykata respektoi dispozitat procedurale civile :

Neni 20 i ligjit "Per falimentimin " :

" Ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese dhe rregullon vetem procedurat e nisura pas hyrjes se tij ne fuqi".

Neni 4 i ligjit "Per falimentimin " :

" 1. Procedura e falimentimit rregullohet nga ky ligj.

2. Dispozitat e Kodit te Procedures Civile dhe ligjeve te tjera zbatohen vetem per ceshtje qe nuk jane parashikuar ne kete ligj, aq sa nuk bien ne kundershtrim me te .

- Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane eshte kompetente nga pikepamja lendore dhe tokesore per shqyrtimin e kerkeses per celjen e procedures se falimentimit te shoqerise " Besa Agro Invest " sh.p.k.

Ne aspektin lendore kompetenca per gjykimin e kerkesave te lidhura me proceduren e falimentimit i takon gjykates se rrethit gjyqesor (seksioni per gjykimin e mosmarreshjeve tregtare si gjykime te posacme) referuar percaktimeve te nenit 334 te KPrC :

" Ne kompetence te seksioneve per gjykimin e mosmarreshjeve tregtare prane gjykatave te shkalles se pare jane dh) procedurat e falimentimit".

Ne kendveshtrim te kompetences tokesore proceduara e falimentimit shqyrtohet ne gjykatën e falimentimit ku debitori ka qendren kryesore te interesit (person juridik) ose vendbanimin/vendqendrimin (person fizik).

„ Qendra kryesore e interesit ne referim te percaktimeve te ligjit eshte vendi ku debitori kryhen administrimin e interesave te tij ne menyre te rregullt, duke prezumuar si te tille seline e rregjistruar te personit juridik, e njohur publikisht dhe nga te tretet:

Neni 11 i ligjit „ Per falimentimin “

" Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe administrohet ne gjykatën e falimentimit ku debitori ka qendren kryesore te interesit, vendbanimin ose vendqendrimin kur eshte person fizik. Gjykata e falimentimit shqyrton me inisiativen e vet nese ka juridiksion " .

Neni 3 i ligjit " Per falimentimin “

29." Qender kryesore e interesit" eshte vendi ku debitori kryhen administrimin e interesave te tij ne menyre te rregullt dhe njihet si e tille nga palet e treta. Ne rastin e nje tregtari, nje shoqerie tregtare ose ndonje subjekti tjeter juridik, vendi ku debitori eshte rregjistruar ose ka seline e tij do te prezumohet te jete qendra kryesore e interesit, pervecse kur parashikohet ndryshe".

Debitori " Besa Agro Invest " sh.p.k eshte person juridik me seli ne Fushe Kruje, e cila prezumohet te jete qendra kryesore e interesit te ketij subjekti,

bazuar ne percaktimet e siper referuara ligjore. Ne kendveshtrim te ketij konstatimi kompetencen territoriale per gjykimin e kerkeses e gezon Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane ne juridiksionin e te ciles perfshihet vendi ku debitori ka qendren kryesore te interesit.

-kerkesa per celjen e procedures se falimentimit u shqyrtua ne séance degjimore.

Per nevoja te nje procesi te kufizuar ne afate te arsyeshme gjykimi dhe shpejtesise se shqyrtimit te kerkeses per celjen e procedures se falimentimit, ku tejzjatja kohore mund te kete pasoja te pariparueshme ne raport me masen e falimentimit, veprimtarine e debitorit apo interesat e kreditoreve ligji, si rregull, ka disiplinuar gjykimin ne dhome keshillimi. Perjashtimisht ne rastet kur parashikohet nga ligji apo cmohet e nevojshme administrimi i provave te reja, gjykata mund te procedoje me shqyrtimin e kerkeses ne séance degjimore :

Neni 9 i ligjit "Per falimentimin"

" 5.Gjykata e falimentimit gjykon mbi prova shkresore ne dhome keshillimi. Perjashtimisht ajo gjykon ne séance degjimore vetem kur eshte e nevojshme qe te merren prova te reja, pervec atyre shkresore te depozituara".

Shqyrtimi ne séance degjimore i kerkeses se shoqerise " Besa Agro Invest " sh.p.k per celjen e procedures se falimentimit u diktua nga nevoja e administrimit te provave te reja, tej atyre te paraqitura nga pala kerkuese dhe hetimit te ekzistences se shkakut te pretenduar te falimentimit permes ekspertimit kontabel te dokumentacionit qe lidhet me veprimtarine e debitorit.

Persa i takon analizes ligjore te kerkeses per celjen e procedures se falimentimit gjykata cmon si me poshte vijon :

Neni 1 i ligjit "Per falimentimin" :

" Ky ligj percakton rregulla te detyrueshme, te njejta dhe te barabarta per lehtesuar zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive te detyrimeve te debitorit ne nje procedure falimentimi".

Neni 2 i ligjit " Per falimentimin"

" Procedura e falimentimit synon te shlyeje ne menyre kolektive detyrimet e debitorit permes riorganizimit te aktivitetit ose permes likuidimit te te gjitha pasurive te debitorit dhe shperndarjes se te ardhurave".

Ekonomia e tregut eshte pazgjidhshmerisht e lidhur me nderveprimin e operatoreve ekonomik, te cilet per shkaqe te ndryshme (te diktuar nga menaxhimi i aktivitetit apo faktore te tregut) mund te gjendjen ne kushtet e paaftesise financiare per pagimin e detyrimeve, duke demtuar apo pamundesuar vijimesine normale te aktivitetit te tyre. Duke marre ne konsiderate impaktin qe

ka ne ekonomine e brendeshme te nje vendi produkti financiar i operatoreve aktiv ne treg, ligjvenesit ka parashikuar aktivizimin e mekanizmave ligjore te cilet :

a) garantojne trajtimin e perbashket dhe efikas te pretendimeve te kreditoreve ndaj debitorit te gjendur ne kushtet e paaftesise paguese (*mekanizmat e likujdimit*). Ne kete rast subjektet e paafta nga pikepamja menaxheriale dhe financiare dalin nga tregu pas likujdimit te tyre.

b) organizimin e biznesit per ta rikthyer ne gjendjen e shendetshme fillestare, cka do ti mundesoj dhe shlyerjet ne vijimesi te detyrimeve (*mekanizmat e riorganizimit*). Shpesh here subjekte te suksesshme financiare mund te gjenden ne situata te papritura dhe te perkohshme paaftesie paguese. Per te shmangur daljen e tyre jashte tregut, ne kushtet e ekzistences se premisave pozitive te rikuperimit te gjendjes se veshtire financiare, mund qe likujdimi dhe perfundimi i personalitetit juridik te shmanget permes nje plani riorganizimi, i konceptuar si nje marreveshje e arritur ne menyre kolektive nga te gjitha kreditorët dhe gjykata e falimentimit. Zbatimi i mekanizmave te riorganizimit eshte misherim i qellimit publik qe synon te garantoj ligji „Per falimentimin“, pjese e politikave ekonomike te shtetit, me qellim per te siguruar vijimesine e veprimtarise se subjektit ne treg, marredheniet e punesimit sikurse dhe kontributin e tij financiar ne buxhet.

Permbushjen e ketij roli te rendesishem permes mekanizmave te siper referuar e realizon ligji „Per falimentimin“ i cili nga njera ane disiplinon rregullat per identifikimin e miratimin e pretendimeve te kreditoreve dhe nga ana tjeter garanton ne menyre te organizuar ekzekutimin plotesisht ose pjeserisht te pretendimeve te tyre.

Kerkesa per hapjen e procedures se falimentimit mund te paraqitet nga debitori ose kreditorët, duke zbatuar urdherimet e ligjit ne lidhje me dokumentacionin qe duhet ti paraqesin gjykates permes te cilit vertetojne shkakun ligjor te falimentimit :

Neni 13 i ligjit „ Per falimentimin“:

„Fillimi i procedures se falimentimit mund te kerkohet nga debitori ose kreditorët dhe ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne kete ligj“

Subjektet e siper referuar kane interes te ligjshem per te aktivizuar procedurat ligjore te falimentimit. Ndersa debitori synon te likujdoje permes nje procedure kolektive debite ndaj te gjitha kreditoreve te tij duke kenaqur maksimalisht pretendimet e tyre, kreditorëve u mundesohet permbushja e kredise permes rregullave te organizuara dhe kontrolluara nga gjykata, proces i cili rezulton te jete me efektiv se nje procedure individuale ekzekutuese gjate te ciles

ngarkohet me shpenzime, perballet me zvarritje kohore te procedurave apo dhe riskun e fshehjes ose pakesimit te pasurise se debitorit per shkak te tjetersimit (*gjate falimentimit mbrohet masa e falimentit*). „ Falimentimi eshte nje proces administrimi, mbikqyrje, hetimi dhe vendimmarrje, funksione te ushtruara nga administratori i falimentimit dhe gjykata ne perputhje me kompetencat, afatet dhe procedurat e parashikuara ne ligj. Permes procesit te falimentimit debitori clirohet nga teresia e detyrimeve ne ngarkim te tij duke u likujduar dhe perfunduar me pas personalitetin e tij juridik ose i sigurohen mundesi riorganizimi me qellim rikuperimin e situates se veshtire financiare, pagesen e detyrimeve permes nje plani riorganizimi dhe vijimesine e aktivitetit te tij ekonomik.

Ne ceshtjen objekt shqyrtimi gjykata eshte investuar nga vete pale debitore shoqeria “ Besa Agro Invest “ sh.p.k e cila pretendon se gjendet ne kushtet e paaftesise paguese, shkak ligjor per celjen e procedures se falimentimit. Nga provat e administruara ne gjykim provohet se vendimi per celjen e procedures se falimentimit eshte marre nga organi me i larte vendimmarres i shoqerise, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e perbere nga ortakun i vetem Fondacioni “ Albanian Besa Capital”. Konkretisht me vendimin nr 105, dt 17.07.2023 asambleja ka vendosur :

- deklarimin e fillimit te procedurave te falimentimit ne ane te likujdimit te shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k;
- paraqitjen e kerkeses prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Durres per caktimin e administratorit te falimentimit dhe marrjen e mases se sigurimit ;
- ngarkohet administratori i shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k z. Estref Cekrezi te ndjeke procesin gjyqesor mbi proceduren e falimentimit duke perfaqesuar shoqerine ne kete process sipas te gjitha tagrave qe i ngarkohen nje administratori te debitorit ne ligjin perkates te falimentimit;
- administratori ngarkohet me nenshkrimin e dokumentave te nevojshem si kerkesa, caktimin e avokateve per pergatitjen e informacionit dhe akteve te nevojshme si dhe te gjithe dokumentat qe shoqerojne kerkesen.
- administratori ka te drejte te autorizoj dhe persona te tjere sipas rastit.

Kerkesa per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k eshte nenshkruar nga administratori i saj Estref Cekrezi.

Sa me siper inicimi i procedurave gjyqesore te falimentimit nga pala debitore eshte realizuar ne perputhje me kerkesat e nenit 15 te ligjit „ Per falimentimin „ i cili sanksionon :

“ 1.Debitori ka per detyre te paraqese kerkesese per fillimin e procedurave te falimentimit brenda 60 diteve nga data ne te cilin dinte ose duhet te dinte qe

eshte bere i paaftte te paguaje. Ne rastin e subjekteve juridike ky detyrim i takon cdo anetari te organit drejtues.....

2.Nese nje kerkese e tille nuk eshte paraqitur bashkarisht nga te gjitha anetaret e organit drejtues ose te gjitha anetaret e shoqerise se thjeshte, kerkesa do te lejohet nga gjykata e falimentimit nese shkaqet e parashikuara per te filluar proceduren e falimentimit jane te mjaftueshme dhe bindese. Gjykata e falimentimit degjon anetaret e tjere te organit drejtues dhe anetaret e shoqerise se thjeshte qe nuk i bashkuar kerkeses perpara se te marre vendim“.

Procedura e falimentimit mund te hapet vetem ne kushtet e paaftesise paguese te debitorit, e cila mund te jete ekzistente ne kohen e paraqitjes se kerkeses ose e paevitueshme ne nje te ardhme te afert. Debitori i cili i drejtohet gjykates per celjen e procedures se falimentimit ka barren e proves te provoj shkakun ligjor te falimentimit :

Neni 14 i ligjit “ Per falimentimin “ :

“ Kerkesa e debitorit per hapjen e procedures se falimentimit mbeshetet ne paaftesine paguese ekzistuese te debitorit ose paaftesine paguese ne nje te ardhme te afert.“

Perkufizimin e gjendjes se paaftesise paguese te debitorit e gjejme ne nenin 3 te ligjit „ Per falimentimin „ :

21. „ Paaftesi paguese“ eshte gjendja kur nje debitor, pavaresisht nese eshte person fizik apo juridik, nuk eshte ne gjendje te paguaje borxhet e tij brenda afatit.Ne rastin e nje personi juridik paaftesia paguese eshte gjithashtu gjendja financiare ne te cilen teresia e detyrimeve te debitorit, tejkalon vleren totale te pasurive te tij“.

Paaftesia paguese ekzistuese i referohet situates kur debitori eshte ne pamundesi per te shlyer detyrimet qe jane maturuar. Ndersa paaftesia paguese ne nje te ardhme te afert konceptohet si pamundesia e debitorit qe te shlyej ne ditën e maturimit detyrimet qe do te behen te kerkueshme ne te ardhmen. Ne te dyja rastet duhet te hetohet mundesia e debitorit per te shlyer detyrimet pa shitur asetet e tij, te cilat jane te domosdoshme per zhvillimin e aktivitetit.

Ne rastin kur kerkesa per hapjen e procedures se falimentimit paraqitet nga debitori duhet domosdoshmerisht te depozitohet dhe dokumentacioni qe verteton paaftesine e tij paguese e tij referuar percaktimee te nenit 14 te ligjit „ Per falimentimin“ :

„“ Kerkesa e debitorit per hapjen e procedures se falimentimit mbeshetet ne paaftesine paguese ekzistuese te debitorit ose paaftesine paguese ne nje te ardhme te afert. Se bashku me kerkesen debitori paraqet dhe dokumentacionin dhe informacionin ne vijim:

a) raportin e debitorit ku paraqiten shkaqet e paaftesise paguese dhe analiza e tij per te ardhmen e biznesit.

b) ekstraktin historik te leshuar nga QKB per debitorin ;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare per tre vitet e fundit te aktivitetit te debitorit. Ne rast se debitori ka ushtruar veprimtari per nje periudhe me te shkurter kohe, per aq sa kjo periudhe eshte ;

c) listen e pronave te luajtshme dhe te paluajtshme, perfshire :

i) vleren e cdo pasurie te paluajtshme ne momentin e blerjes ;

ii) vleren aktuale te tregut nese keto pasuri kane qene objekt rivleresimi ;

iii) vendndodhjen e pasurive dhe/ose

iv) te dhenat e rregjistruara ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme nese jane objekt i ndonje procedure ligjore dhe

v) nese ndonje nga keto pasuri eshte vendosur si garanci dhe objekt barre dhe nese po vlera e kredise se siguruar.

d) liste te bilanceve aktuale te parave ne gjendje dhe burimet e te ardhurave ;

dh) lista e kreditoreve te cilet jane persona fizike, perfshi emrat, adresen , vleren dhe burimin e detyrimeve;

e) listen e kreditoreve te cilat jane persona juridike, perfshi emrat, adresat, selite, emrat e perfaqesuesve te tyre ligjore dhe nese eshte rasti vleren dhe burimin e detyrimeve;

e) listen e debitoreve te debitorit, qofte keta persona fizike apo juridike. perfshi emrat e tyre, adresat, selite, vlerat dhe burimin e kredise;

f) listen e te gjitha procedurave ligjore ku debitori eshte pale si padites ose i paditur.

2. Dokumentat sipas pikes 2 te ketij neni duhet te jene origjinale, te nenshkruara dhe/ose te vulosura ne cdo faqe dhe te shoqeruara nga nje deklarate ku shprehet se permbajtja e dokumentave shoqeruese eshte e plote dhe e sakte. Nese ka arsye te bazuara se permbajtja e dokumentave nuk eshte plote dhe e sakte, duhet te percaktohet shprehimisht ne tekstin e deklarates....“

Nese dokumentacioni i siper referuar nuk eshte i plote debitorit i caktohet afat 5 dite per ta plotesuar. Nese ky urdherim i gjykates nuk respektohet prej tij kerkesa kthehet pa u shqyrtuar :

Neni 17/2 i ligjit „ Per falimentimin“ :

“ 2. Nese dokumentat e percaktuar ne nenin 14 te ketij ligji nuk jane te plota debitori i ploteson brenda 5 diteve. Nese brenda kesaj periudhe debitori nuk ploteson kerkesen , atehere kerkesa e tij kthehet e pashqyrtuar „,

Kerkuesi “ Besa Agro Invest “ sh.p.k pas plotesimit te dokumentacionit ne perputhje me kerkesat e nenit 14 te ligjit „Per falimentimin „, depozitoi ne cilesine e proves :

1.ekstraktin historik te leshuar nga QKB ku evidentohet data e rregjistrimit, NIPT, selia, objekti i veprimtarise, themeluesit (ortaket filletare) dhe ndryshimet vijuese ne ortakeri, organet drejtuese dhe ndryshimet ne perberjen e tyre nder vite dhe cdo vendim i marre nga shoqeria i cili eshte rregjistruar ne QKB. Referuar ekstraktit aktual te QKB-se shoqeria rezulton me qender ne Fushe Kruje Arrameras, nr pasurie 328/75, vol 14, fq 209, ZK 1042, NIPT L41726002A dhe ortak te vetem qe zoteron 100 % te kuotave fondacionin “ Albanian Besa Capital”, i rregjistruar me vendimin nr 287, dt 19.09.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Ndersa objekti i veprimtarise se shoqerise “ Besa Agro Invest “ sh.p.k eshte : „ *Kultivim i kulturave te ndryshme bujqesore dhe tregetimi i tyre me shumice dhe pakice. Kultivimi i ullirit, vreshtave, pemeve frutore me qellim tregetimin e produkteve dhe nenprodukteve te tyre me shumice dhe pakice. Prodhimi i farerave, fidaneve dhe tregetimi i tyre. Ngritja e industrise perpunuese te prodhimeve bujqesore dhe blegetorale. Ngritja dhe zhvillimi I agroturizimit. Eksperimentimi I teknologjive te reja ne kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore. Import, eksport, tregetim me shumice dhe pakice i te gjitha produkteve bujqesore dhe blegetorale. te perpunuara, te fresketa, te gjalla, blerjes se farerave, fidaneve, medikamenteve te ndryshme per mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit. Import, eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice i makinerive per prodhim bujqesor dhe blegetoral, traktore, mjete transporti, linja dhe makineri te perpunimit te produkteve agro ushqimore. Nxitjen dhe organizimin e te gjitha aktiviteve qe kane te bejne me prodhimin dhe perpunimin e produkteve te fermereve.Konsulence ne fushen e ekonomise, bujqesise, blegetorise dhe ushqimit duke perfshire planet e menaxhimit te cilesise, mjedisit, turizimit dhe agroturizmit. Shoqeria do te ushtroj aktivitetin e saj bazuar te lejet, licensat aprovimet apo autorizimet e tjera te ligjshme te leshuara nga institucionet qeveritare kompetente te fushes”.*

2.Raporti i paaftesise paguese i hartuar nga debitori, ku analizohet gjendja aktuale financiare dhe pritshmerite per te ardhmen.

Ecuria financiare e veprimtarise se shoqerise gjen pasqyrim ne pasqyrat financiare te viteve 2020, 2021, 2022. Rezultati financiar i shoqerise per tre vitet e fundit ka qene me humbje duke pakesuar kapitalet e veta dhe duke krijuar veshtiresi ne likuidimin e detyrimeve (ne analize jane marre ne konsiderate llogarite e mjeteve monetare, llogarite e te drejtave te arketueshme, llogaria e inventarit, llogarite e aktiveve afatgjata, detyrimet afatgjate,

vështirë aftësie paguese, pasi aktivet e saj afatshkurtra nuk mund të mbulojnë detyrimet afatshkurtra.

2.Referuar analizës së gjendjes së pasurive të debitorit dhe likuiditetit të saj rezulton se debitori ka mundësi të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit.

3. Duke marrë në konsideratë se kërkesa për celjen e procedurës së falimentimit është paraqitur nga debitori i cili ka detyrimin ligjor për mbrojtjen e masës së falimentimit, nuk cmohet e nevojshme mbikqyrja e veprimtarisë së debitorit.

Ne konkluzion gjykata cmon se kërkesa e debitorit "Besa Agro Invest" sh.p.k për hapjen e procedurës së falimentimit është e bazuar në ligjin „Për falimentimin“ në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e shkakut të falimentimit, paaftësia paguese e debitorit.

PER KETO ARSYE

Ne bazë të nenëve 306 dhe 309 të KPrC, gjykata

VENDOSI

1.Pranimin e kërkesës.

2.Hapjen në dt 04.03.2024, ora 15 të procedurave të falimentimit për shoqërinë BESA AGRO INVEST sh.p.k, NIPT L41726002A, rregjistruar me dt 26.05.2014, me qendër të ushtrimit të aktivitetit në Durrës, Fushe Krujë, Arrameras, rruga e Celeve, Fushe – Krujë, Arrameras, me ortak Fondacioni "Albanian Besa Capital", me administrator z. Estref Cekrezi dhe objekt veprimtarie "Kultivimi i kulturave të ndryshme bujqësore dhe tregëtimin e tyre me shumicë dhe pakicë.Kultivimi i ullirit, vreshtave dhe pemëve frutore me qëllim tregëtimin e produkteve dhe nënprodukteve të tyre me shumicë dhe pakicë. Prodhimin e farërave dhe fidaneve dhe tregëtimin e tyre. Ngritjen e industrisë perpunuese të prodhimeve bujqësore dhe blegetorale. Ngritjen dhe zhvillimin e agroturizimit. Eksperimentimin e teknologjive të reja në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Import – eksport dhe tregëti me shumicë dhe pakicë të të gjitha prodhimeve bujqësore blegetorale të perpunuara (industrializuara), e të fresketa të gjalla, blerjes së farnave, fidaneve, medikamenteve të ndryshme për mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit.

Import – eksport dhe tregeti me shumice dhe pakice te makinerive per prodhim bujqesor dhe blegetoral, traktore, mjete transporti si dhe linja dhe makineri te perpunimit te produkteve agro – ushqimore etj. Nxitjen dhe organizimin e te gjitha aktiviteteve qe kane te bejne me prodhimin dhe tregetin e prodhimeve te fermereve. Konsulence ne fushen e ekonomise, bujqesise, blegetorise dhe ushqimit, duke perfshire planet e menaxhimit te cilesise, mjedisit, turizmit dhe agroturizmit”.

3. Caktimin si administratore e falimentimit te zj. Shpresa Breçani, atesia Dem, amesia Hajrie, dtl 20.03.1964, lindur ne Tropoje, banuese ne Tirane, adresa rruga “ Panorama” pallati Sara – El, me nr licence 09 dhe ID G45320378H.

3. Te gjitha kreditorët e shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k duhet te paraqesin pretendimet e tyre prane administratores se falimentimit zj. Shpresa Breçani, brenda 45 diteve nga publikimi i vendimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

4. Te gjitha kreditorët e shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k duhet te njoftojne administratoren e falimentimit Shpresa Breçani per pretendimet dhe te drejtat e tyre te siguruara mbi pasurine e debitorit.

5. Personat qe kane detyrime ndaj debitorit shoqeria BESA AGRO INVEST sh.p.k duhet ti paguajne dhe shlyejne ato prane administratores se falimentimit Shpresa Breçani.

6. Mbledhja e kreditorëve te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k per raportim te mbahet brenda 60 diteve nga shpallja e ketij vendimi.

7. Mbledhja e kreditorëve te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k te mbahet brenda 60 diteve nga perfundimi i afatit te depozitimit te pretendimeve te tyre.

8. Urdherohet publikimi i shkurtimit te ketij vendimi ne faqen zyrtare te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne Fletoren Zyrtare.

9. Nje kopje e ketij vendimi ti komunikohet administratores se falimentimit Shpresa Breçani.

10. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Agjensise Shteterore te Kadastres, me qellim njoftimin te gjitha Drejtorive Rajonale te Agjensise Shteterore te Kadastres.

11. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet te gjithë bankave te nivelit te dyte ne RSH.

12. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

13. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Drejtorise se Pergjithshme te Doganave.

14. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Autoritetit Rrugor Kombetar.

15. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Agjensise se Mbikqyrjes se Falimentimit prane Ministrise se Drejtesise.

16. Nje kopje e ketij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqerise BESA AGRO INVEST sh.p.k ti komunikohet Dhomes Kombetare te Notereve.

17. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkusit.

18. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit.

U shpall ne Tirane me dt 04.03.2024

SEKRETARE
AURORA CAHANI

GJYQTARE
ANTONELA PRENDI

SHPENZIMET GJYQESORE

Takse gjyqesore 200 leke

Shpenzime ekspertimi 60 000 leke

Vendimi mori formë të prarë pasi
nuk u ankimua më dt 30.05.2024
Tiranë më dt 03.06.2024

K / SEKRETAR
MIMOZA TAPA



